



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Nr _____prot

Tiranë më _____.____.2024

**VENDIM
Nr. 350, datë 09.07.2024**

PËR

**KUALIFIKIMIN E KANDIDATES ZNJ. {...} DHE VIJIMIN E PROCEDURAVE
TË NGRITJES NË DETYRË NË GJYKATËN ADMINISTRATIVE TË APELIT,
PËR POZICIONIN E LIRË TË SHPALLUR ME VENDIMIN NR. 235 DHE NR.238,
DATË 24.05.2023, TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në pikën 3, të nenit 136, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 8, në pikën 5, të nenit 47, në pikat 7 dhe 8, të nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në shkronjën “dh”, pika 12, Seksioni Ç, Kreu VI, të Vendimit të tij nr. 75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjorë për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, pasi shqyrtoi materialet e çështjes dhe relacionin e përgatitur nga relatori, z. Klodian Kurushi,

VENDOSI:

1. Kualifikimin e kandidatës znj. {...} dhe vijimin e procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit, për pozicionin e lirë, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 235 dhe nr. 238, datë 24.05.2023.
2. Vendimi nr. 114, datë 06.03.2024, i Këshillit të Lartë Gjyqësor është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatës znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR